



KOMUNA VUSHTRRI

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br 1663/24

Nr. l fq. / Br. sf

Data: / Datum 05.11.2024

VUSHTRRI - VUČITRN

SPEEEX

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

I LIDHUR NDËRMJET

SPEEEX EDUCATION SH.P.K

&

KOMUNËS SË VUSHTRRISE

Nëntor 2024



KOMUNA VUSHTRRI



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në mes:

- Komunës së Vushtrrisë të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z. Ferit Idrizi (në tekstin e mëtejme Komuna) dhe
- Speeex Education, të cilin e përfaqëson z. Fikret Murati, Përfaqësues (në tekstin e mëtejme SE).

Neni 1 Qëllimi

1.1 Qëllimi i këtij memorandumi është bashkëpunimi midis palëve në lidhje me platformën Speeex Education TechLab, e cila ofron trajnimë profesionale në fushën e zhvillimit softuerik.

1.2 Ky bashkëpunim synon të mbështesë zhvillimin e aftësive profesionale të të rinjve nga Komuna e Vushtrrisë, duke u ofruar atyre mundësi për përmirësimin e njohurive dhe aftësive në teknologji dhe zhvillim softuerik.

1.3 Palët do të bashkëpunojnë për të siguruar që trajnimet të jenë të aksesueshme dhe të dobishme për të rinjtë në këtë komunitet.

Neni 2 Objektivat

Objektivat kryesore të këtij Memorandumi janë:

2.1 Zhvillimi i Moduleve të Trajnimit: Speeex dhe Komuna e Vushtrrisë bien dakord të zhvillojnë dhe ofrojnë module trajnimi të strukturuar për fushën e zhvillimit softuerik, duke përfshirë të gjitha fazat e ciklit të jetës së zhvillimit të softuerit.

2.2. Kategoritë e Trajnimeve: Trajnimet do të organizohen në disa kategori, përfshirë por pa u kufizuar në:



KOMUNA VUSHTRRI

- 2.2.1 Zhvillimi i aplikacioneve web
- 2.2.2 Zhvillimi i aplikacioneve mobile
- 2.2.3 Programimi me gjuhë specifike (p.sh. FRONT END / BACK END / JAVA PROGRAMMING)
- 2.2.4 Bazat e të dhënave dhe administrimi i tyre
- 2.2.5 Arkitektura e softuerit dhe dizajnimi i sistemeve

2.3 **Aplikimet Praktike:** Modulet e trajnimit do të përfshijnë aplikime praktike dhe projekte të vërteta, ku pjesëmarrësit do të punojnë në krijimin dhe zhvillimin e aplikacioneve reale, me qëllim të përgatitjes së tyre për sfidat e tregut të punës.

2.4 **Qasja Tek Praktikrat më të Mira:** Trajnimet do të përqendrohen në praktikrat më të mira të industrisë, metodologjitë agile, dhe përdorimin e teknologjive më të fundit për zhvillimin e softuerit.

2.5 Këto objektiva synojnë të ofrojnë trajnim të plotë dhe të gjithanshëm për të rinjtë nga Komuna e Vushtrrisë, duke i përgatitur ata për punësim në tregun e teknologjisë së informacionit.

Neni 3 Mënyra e financimit

3.1 Palët bien dakord që kostoja mujore e trajnimit për pjesëmarrësit është 250 (dyqind e pesëdhjetë) Euro.

3.2 Nga kjo shumë, 40% ose 100.00 € (njëqind euro) do të subvencionohen nga Speeex, ndërsa pjesa tjetër prej 60% ose 150.00 € (njëqind e pesëdhjetë euro) do të subvencionohet nga Komuna e Vushtrrisë – subvencione dhe transfere të Drejtorisë për Arsim.

3.3 Pagesat për trajnimet do të bëhen në bazë mujore, duke u shpërndarë sipas përqindjeve të mësipërme, dhe secila palë duhet të kryejë pagesën për pjesën e saj brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të faturës në komunë. Bashkëngjitur me faturë duhet dorëzuar gjithashtu nga nje ekzemplar të certifikatës për secilin kandidat për kryerje me sukses të trajnimit profesional të përcaktuar në këtë marrëveshje.

Neni 4 Kohëzgjatja e trajnimit

Trajnimi i kandidatëve të regjistruar të përcaktuar në pikën 2.2 të kësaj marrëveshje do të zgjasë 3 (tre) muaj.



KOMUNA VUSHTRRI

SPEEEX

Neni 5 Konfidencialiteti

Palët pajtohen se do të trajtojnë si konfidenciale të gjithë informacionet e fituara gjatë zbatimit të këtij Memorandumi, me mirëkuptimin që të mos i zbulojnë këto informata palëve të treta pa miratim paraprak me shkrim.

Neni 6 Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të vlejë nga dita e nënshkrimit deri në fund të vitit 2025.

Neni 7 Mbikëqyrja

Mbikëqyrës në zbatimin e kësaj marrëveshje do ta bëjë zyrtari i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa i cili do të caktohet me vendim të kryetarit të komunë propozuar nga drejtori i kësaj drejtorie.

Neni 8 Ndërprerja e Marrëveshjes

8.1 Ndërprerja e memorandumit të bashkëpunimit bëhet përmes njoftimit me shkrim për palën tjetër me një dëshmi të pranimit të këtij njoftimi. Ndërprerja hyn në fuqi pas kalimit të një periudhe prej 30 ditësh nga data e pranimit të njoftimit me shkrim.

8.2 Nëse implementimi i projektit duhet të ndërpritet për shkak të ngjarjeve të fuqisë mbinatyrore dhe rrethanave të tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me palët tjera relevante, për veprimet e mundshme që duhet ndërmarrë.

Neni 9 Amandamenti

9.1 Ky Memorandum përcakton bashkëpunimin reciprok ndërmjet Speeex dhe Komunës së Vushtrrisë.

9.2 Çdo ndryshim në këtë marrëveshje duhet të bëhet në formë të shkruar dhe të pranohet nga të dyja palët.



KOMUNA VUSHTRRI

SPEEEX

Neni 10

Zgjidhja në rast të mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega ne Vushtrri.

Neni 11

Kopjet dhe gjuha e Marrëveshjes

11.1 Ky Memorandum është përpiluar në katër (4) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

11.2 Secila palë do t'i ketë nga dy kopje origjinale të nënshkruar.

Neni 12

Hyrja në fuqi

12.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

12.2 Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, palët kuptojnë dhe pranojnë kushtet e përcaktuara në të njejtën.

PALËT NËNSHKRUESE

Më _____ 2024

SPEEEX SH.P.K

Fikret Murati
Fikret Murati



Kryetari i Komunës

Ferit Idrizi
Ferit Idrizi